



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Seanca nr.2002/23  
Prishtinë,më 19 dhjetor 2002,ora 10:15  
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi z.**Nexhat Daci**,kryetar i Kuvendit të Kosovës(bashkëkryesues z.Xhavit Haliti).  
**Kryesusi** konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë,gjithsej 89 dhe shpalli të hapur punën e saj.

Për këtë seancë ishte propozuar ky

**RENDI DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesverbali nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit "Për Inspektoratin e Punës në Kosovë-2002/9";
4. Gjendja Energjetike në Kosovë;dhe
5. Parashtrimi i pyetjeve.

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

Kryesusi kërkoi nga deputetët e Kuvendit miratimin e rendit të ditës.

**Sabri Hamiti** në emër të grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që me procedurë të shpejtë të vëhet në reend të ditës të seancës së sotme:buxheti i Kosovës për vitin 2003 dhe Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2003.

**Flora Brovina** tha se e përkrahë propozimin e grupit parlamentar të LDKsë. Ajo kërkoi që edhe çështja e personave të rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës të vëhet në rend të ditës.

**Bujar Dugolli** tha se i përkrahë propozimet e grupeve parlamentare të PDK-së dhe LDK-së, por gjërat të cilat diskutohen në Kuvend duhet të përfundojnë, theksoi ai dhe nuk duhet të ndodh si me rastin e emrimit të prokurorëve dhe gjyqëtarëve nga ana z. Steiner, pa pëlqimin e Kuvendit.

**Hasan Meta** tha se i përkrah propozimet e dy grupeve parlamentare. Ai kërkoi që edhe çështja e decentralizimit të vëhet në rend të ditës.

**Ministri Ali Sadriu** tha se Kuvendi është dashur që fillimisht ta nxjerrë Ligjin për Buxhetin e Kosovës dhe pastaj të shyrtojë dhe miratojë buxhetin e Kosovës për vitin 2003. Ai kërkoi që debati për buxhetin e Kosovës të shtyhet për një ditë më vonë, në mënyrë që materialet e nevojshme të përgatiten për deputetët e Kuvendit.

**Xhezair Murati** shprehu shqetësimin e tij lidhur me ngritjen e çështjes së decentralizimit, ngase askush nuk është konsultuar me përfaqësuesit e komunitetit boshnjak për këtë çështje. Ai kërkoi që çështja e decentralizimit të përgatitet mirë dhe të shtrohet në njëren nga seancat e ardhshme të Kuvendit.

**Kryesusi** tha se është kërkesë unanime e të gjitha grupeve parlamentare që të vëhet në rend të ditës çështja e buxhetit të Kosovës dhe e hodhi atë në votim. Të gjithë deputetët e pranishëm u pajtuan që çështja e buxhetit të Kosovës për vitin 2003 të vëhet në rend të ditës të kësaj seance. Kurse për çështjet e nritura nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, theksoi kryesusi paraprakisht duhet të përgatiten dhe pastaj të vëhen në rend të ditës dhe të debatohen në Kuvend.

**Hydajet Hyseni** tha se shumë çështje është dashur që të vëhen në rend të ditës si "çështje urgjente" (përkujtoi disa kërkesa të PDK-së) për të cilat nuk është vepruar ashtu, kurse për gjërat që është dashur të shtrohen në mënyrë të rregulltë, si çështja e buxhetit tani ngritet si çështje urgjente. Ai tha se disa herë çështjen e buxhetit e ka shtruar në mbledhjet e Kryesisë, por nuk e ka pasur përkrahjen e anëtarëve tjerë të saj. Grupi i PDK-së ka kërkuar që të vëhet në rend të ditës edhe çështja e funksionimit të Kuvendit, theksoi z. Hyseni dhe si pasojë e shumë ngatresave është edhe mos funksionimi i tij.

## **2. Procesverbali nga seanca e kaluar.**

Nuk pati vërejtje në proseverbalin nga seanca e kaluar dhe ai u miratua.

## **3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit "Për Inspektoratin e Punës në Kosovë-2002/9".**

Kryesusi i informoi deputetët për rrjedhën e harmonimit të amendamenteve në P/ligjin Për Inspektoratin e Punës dhe i ftoi ata që të votojnë për secilin amendament një nga një.

Amendamenti 1-miratohet;

Amendamenti 2-miratohet;

Amendamenti 3-miratohet;  
Amendamenti 4-miratohet;  
Amendamenti 5-miratohet;  
Amendamenti 6-refuzohet;  
Amendamenti 7-refuzohet;  
Amendamenti 8-miratohet;  
Amendamenti 9.1-miratohet;  
Amendamenti 9.2-refuzohet;  
Amendamenti 10-miratohet  
Amendamenti 11-miratohet;  
Amendamenti 12-miratohet;  
Amendamenti 13-miratohet;  
Amendamenti 14.1-miratohet;  
Amendamenti 14.2-refuzohet;  
Amendamenti 15-miratohet;  
Amendamenti 16-miratohet;  
Amendamenti 17-miratohet;  
Amendamenti 18-miratohet;  
Amendamenti 19-miratohet;  
Amendamenti 20.1-miratohet;  
Amendamenti 20.2-refuzohet;  
Amendamenti 21-miratohet;  
Amendamenti 22-miratohet;  
Amendamenti 23-miratohet;  
Amendamenti 24-miratohet;  
Amendamenti 25-miratohet;  
Amendamenti 26-miratohet;  
Amendamenti 27-miratohet;  
Amendamenti 28-miratohet;  
Amendamenti 29-miratohet;  
Amendamenti 30-miratohet;  
Amendamenti 31-miratohet;  
Amendamenti 32-miratohet;  
Amendamenti 33-miratohet;  
Amendamenti 34-miratohet;  
Amendamenti 35.1-miratohet;  
Amendamenti 35.2-miratohet;  
Amendamenti 36-miratohet;  
Amendamenti 37-miratohet;  
Amendamenti 38-miratohet;  
Amendamenti 39-miratohet;  
Amendamenti 40-miratohet;  
Amendamenti 41-miratohet;  
Amendamenti 42-miratohet;  
Amendamenti 43-miratohet;  
Amendamenti 44-miratohet.

Pas votimit të amendamenteve, kryesusi e hodhi në votim Ligjin në tërsi dhe rezultati ishte:

Për -----88?  
Kundër-----0;  
Abstenime—1.

**Kryesusi konstatoi se Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin “Për Inspektoratin e Punës në Kosovë-2002/9” dhe dha gjysmë ore pauzë.**

Pas pauzës seancën e kryesoi z.Xhavit Haliti.

#### **4. Gjendja energjetike në Kosovë.**

**Kryesusi** e ftoi përfaqësuesin e grupit parlamentar të PDK-së (si propozues i kësaj pike të rendit të ditës) që të marrë fjalën për diskutim lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë.

**Fatmir Limaj** tha se pa 28 kërkesave me shkrim të grupit parlamentar të PDK-së drejtuar Kryesisë së Kuvendit, për herë të parë ajo ka vënë në rend të ditës një kërkesë të tje. Kryesia e Kuvendit nuk e ka përgjitur mirë këtë pikë të rendit të ditës dhe nuk e ka kryer detyrën e vetë, theksoi z.Limaj.

Kosova po futet edhe në këtë vit në një kolaps energjetik, në një gjendje të rëndë energjetike e cila po i tejkalon kufijtë e durshmërisë qyteare, vazhdoi z.Limaj. Kuvendi duhet të debatojë këtë çështje mbi bazën e informacioneve për gjendjen energjetike në KEK; sa ka kapacitet prodhues KEK-u sot; Sa energji importohet apo eksportohet; Sa kanë qenë investimet dhe si kanë shkuar ato; Sa kanë qenë të sukseshme dhe sa kanë dështuar ato; A ka keqpërdorime apo jo në KEK; Cilat janë objektivat e KEK-ut për të dalë nga ky kaos energjetik që e ka kapluar Kosovën?

Kjo pikë pikë e rendit të ditës në tërësi nuk është e përgatitur, theksoi z.Limaj dhe kërkoi që Kuvendi i Kosovës të autorizojë Komisionin për Tregti dhe Industri të Kuvendit që të kërkojë informacione nga përgjegjësit në KEK për çështjet që i shtroi më lartë dhe të përgatisë një raport për gjendjen energjetike në Kosovë në bazë të së cilit deputetët e Kuvendit do të diskutonin në njëren nga seancat e ardhshme të Kuvendit.

**Sabri Hamiti** tha se përkrah parafolsin e tij lihur me problemet që ai i ngriti. Duhet të gjenden forma për mbledhjen e informacioneve nga kompetentët, ekspertët dhe përgjegjësit dhe pastaj diskutimi do të ishte më funksional dhe më i dobishëm, theksoi z.Hamiti. Ai shfaqti shqetsimet lidhur me mospagimin e rrymës si nga shtresat sociale që nuk kanë mundsi, por dhe nga ato që kanë dhe nga organizatat ekonomike dhe institucionet e tjera që e harxhojnë rrymën por nuk e paguajnë atë.

Kjo më tepër është çështje e (mos)kulturës së atyre që e shfrytëzojnë dhe nuk e paguajnë rrymën dhe problemi qëndron në atë se si të mësohen konsumatorët që të paguajnë atë që konsumojnë, pëfundoi z.Hamiti.

**Ramush Haradinaj** tha se pajtohet me parafolsin e tij se gjendja energjetike në Kosovë është e keqe dhe nuk mund të qëndrojmë indiferent në këtë situatë. Grupi parlamentar i AAK-s e përkrahë iniciativën për shqyrtimin e kësaj gjendje në Kuvend dhe Komisioni

përkatës i Kuvendit duhet të kërkojë informacione nga përgjegjësit në KEK, Qeveria dhe nga administrata e OKB-së në Kosovë. Është me rëndësi ,vazhdoi z. Haradinaj që në këtë situatë të krizës energjetike në Kosovë që opinionin të dijë se cka po ndodhë dhe të ketë transparencë për këto çështje pse jemi në këtë situatë dhe si mund të dalim nga kjo.

**Xhezai Murati** tha se çështja që u shtrua këtu është njëra nga vështësit më të mëdha me të cilën po ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Orari i reduktimeve tri orë me rrymë dhe tri pa të e kanë vështërsuar jetën në përgjithësi. Në opinionin po qarkulojnë informata të ndryshme lidhur me situatën e krijuar dhe është mirë, thksoi z. Murati që në këtë Kuvend të diskutohen dhe të bëhen transparente problemet me të cilat po ballafaqohemi. Shuma të mëdha të parave janë harxhuar në blerjen e gjeneratorëve, me të cilat ka mundur që të ndërtohet ndonjë termocentral i ri, thksoi z. Murati. Ai shfaqti shqetësimin tij lidhur me mospagesën e rymës së hargjuar dhe insistoi se duhet gjetur forma që ajo të paguhet nga ana e konsumatorëve.

Për situatën energjetike në Kosovë, problemet dhe mënyrë e daljes nga ajo, diskutuan deputetët: Mahir Jagxhillar, Fatmir Sejdiu, Ramadan Kelmendi, Berat Luzha, Agim Kraniqi, Hasan Meta, Fatmir Rexhepi, Gani Koci, Bajrush Xhemajli, Ilaz Pireva, Lirak Celaj dhe Gani Prekopuca diskutimet e të cilëve i janë bashkangatur transkriptit. Kuvendi pasi diskutoi, vendosi që ta ngarkojë Komisionin për Tregti dhe Industri që të kërkojë informacione nga përgjegjësit në KEK, Ministria përkatëse dhe ekspertë të kësaj lëmie dhe në bazë të tyre të përgatisë një raport i cili do të diskutohet në seancën e arshme plenare të Kuvendit të Kosovës.

#### **5. Parashtrimi i pyetjeve-përgjigjet e ministrave.**

**5.1 Ministri Numan Baliq** i ishte përgjigjur me shkrim znj. Zylfije Hundozi lidhur me gjendjen në QKU, por znj. Hundozi shtoi se nuk është e kënaqur me përgjigjen e ministrit.

**5.2 Ministri Jakup Krasniqi** i ishte përgjigjur me shkrim z. Sahit Krasniqi lidhur me rolin e AKM-së dhe të administratës komunale në ruajtjen e pronës nga uzurpimet.

**5.3 Ministri Rexhep Osmani** iu përgjigji z. Ismajl Kurteshi lidhur me kalendarin e festave në arsim. Përgjigja e z. Osmani i është bashkangjitur transkriptit.

Vazhdim i seancës 23 dhjetor 2003

#### **6. Shqyrtimi i Buxhetit të Kosovës.**

**Kryesusi** e ftoi ministri e Ekonomisë dhe Financave z. Ali Sadriun që të paraqesë ekspozueun për buxhetin e Kosovës për vitin 2003.

**Ministri Ali Sadriu** tha se Projektpropozimi i Buxhetit për vitin 2003 është një dokument i cili mundson një informim të përgjithshëm për agjencitë kryesore dhe në mënyrë të specifikuar për agjencitë të vecanta dhe Ju duhet t'i jepni vlersimet tuaja për atë propozim.

Materiali i pjesës rezervë, shtoi z. Sadriu i cili është bashkangjitur projektpropozimit është i hartuar nga AQF, të cilit Ministria jonë do t'i bëjë një koment të vecantë.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2003 është me sa vijon:

Nga pozicioni i doganave presin të hyra 53.4 milion euro; të hyrat nga TVSH-ja 25 milion euro; tatimi i paragjykuar 27 milion euro; grandet e përgjithsuara nga donatorët do të jenë 25 milion euro.

**Totali i buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2003 do të jetë 489.1 milion euro dhe ka një rritje për 19.505 milion euro krahasuar me vitin e kaluar. 95 % e buxhetit do të financohet nga të hyrat venore, kurse vetëm 5 % nga grandet e donatorëve.**

Ministri Sadriu paraqiti edhe të dhënat për agjencitë e mëdha shpenzuese të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2003 në vijim:

Buxheti i Ministris për Punë dhe Mirëqenie Sociale është 82.60 milion euro; Buxheti i Ministris së arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është 82.88 milion euro; Buxheti i Ministris së sëndetësisë është 61.92 milion euro; Buxheti i Ministris së Shërbimeve publike është 19.80 milion euro; Buxheti i i Ministris së Transportit dhe Komunikacionit është 22.89 milion euro; Buxheti për pushtetin lokal është 141 milion euro; edhe ministrinë e tjera kanë një rritje të buxhetit krahasuar me vitin paraprak, kurse për raste të jashtzakonshme janë paraparë 8.15 milion euro.

Ekspozeu i plotë i ministrinë Ali Sadriu i është bashkangjitur transkriptit.

**Sabri Hamiti** tha se ekspozeu i ministrinë Sadriu jep shumë të dhëna për të menduar pak më thellë dhe është mirë që të bëhet një pauzë për një konsultim të grupeve parlamentare lidhur me Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2003.

**Fatmir Limaj** tha se dëshiron të dijë: a) A munden deputetët e Kuvendit me sygjerimet, dhe diskutimet e tyre të inervenojnë në buxhetin e propozuar, dhe b) Cilat janë kompetencat e ministrisë përkatëse dhe të qeverisë në përgatitjen e tij? Ai kërkoi që të bëhet një pauzë për konsultimin e grupeve parlamentare, të ministrinë përkatës dhe të kryetarit të Kuvendit dhe të shihet se a vlen që të debatohet për çështjen e shtruar?

**Bujar Dugolli** tha se Kuvendi i Kosovës ka shumë problemet të cilat duhet t'i zgjidh dhe paraprijë dhe mos të vijë para aktit të kryer. Z. Dugolli i përkrahu parafolsit e tij për një pauzë për konsultimin e grupeve parlamentare dhe shprehu mendimene tij se nuk do t'i jep besimin këtij projektpropozimi të buxhetit, i cili anashkalon Kuvendin e Kosovës.

**Xhezair Murati** tha se i përkrahu parafolsit e tij dhe në pauzë grupet parlamentare duhet të gjejnë një koncesus për të dalur nga kjo situatë.

**Kryesusi** dha një pazuë të seacës plenare për konsultim të grupeve parlamentare .

**Kryesusi** pas pazuës e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet të Kuvendit që t'i informojë deputetët me qëndrimet e komisionit.

**Haki Shatri** tha se Komisioni për Buxhet i Kuvendit, në mbledhjen që pati gjatë pazuës, shqyrtoi Projektregullorën për shpërndajen buxhetore për vitin fiskal 2003 dhe lidhur me këtë Kuvendit të Kosovës i propozon këtë



## REKOMANDIM

1. Kuvendi i Kosovës është dashur ta ketë rolin qendror në zhvillimin e draftregullorës.
2. Dokumenti është dashur t'i dorëzohet Kuvendit si një projektligj e jo si draftëregullore.
3. Kuvendi nuk pajtohet me ndarjen e buxhetit në tri pjesë: a) në buxhetin e fuqive të rezervuara, b) në buxhetin për IPVQ, dhe c) në buxhetin për komunat.
4. Problemet e theksuara më lart ritheksojnë nevojën për nxjerrjen urgjente të Ligjit për zhvillimin dhe implementimin e buxhetit, pra Ligjit për menaxhimin e finacave publike dhe përgjegjësitë.
5. Nga rishikimi i buxhetit të “fuqive të rezervuara” si pjesë e vecantë, Kuvendi thekson se mbi 2 milion euro janë propozuar për t'i ndarë AMK-së dhe më se gjysma e tyre do të alokohen në kompleksin e Trepcës. Kjo është plotësisht në kundërshtim me këshillat e FMN-së, sipas të cilave nuk duhet të ketë subvencione për ndërmarrjet publike dhe shoqërore. Teksti i plotë i rekomandimit i është bashkangjitur transkriptit.

**Kryesusi** hapi debat lidhur me çështjet e shtruarat.

**Bujar Dugolli** tha se vërejtjet e grupi parlamentar të AAK-së janë: Mitrovica i ka dy buxhete; Trepcë ka buxhet më shumë se TMK-ja; “buxheti i rezervuar” është 20% i kontrolluar nga Stenieri pa dhënë hollësi se ku e shpenzon këtë buxhet dhe shumë çështje tjera problematike na bëjnë që grupi parlamentar i AAK-s nuk e përkrahë në këtë seancë Projektpropozimin për buxhetin 2003 të Kosovës. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, vazhdoi z. Dugolli që të hartojnë Projektligjin për Buxhet në bazë të vërejtjeve të Komisionit për Buxhet dhe në seancën e ardhshme kur të diskutohet kjo çështje do ta themi fjalën tonë.

**Sabri Hamiti** tha se në emër të grupit parlamentar të LDK-s e përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet, të cilin e konsideron esencial për prolemet që dalin rreth miratimit të rregullorës përcjellëse rreth projektit të buxhetit.

**Fatmir Limaj** tha se përkrahë rekomandimin e Komisionit për buxhet dhe kërkoi që të formohet një komision për t'i sqaruar kompetencat e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe UNMIK-ut dhe pastaj ky Kuvend të fillojë përmbajtësisht të punojë dhe vendimet e tij të jenë të pranueshme dhe të respektueshme nga të gjithë.

**Xhezair Murati** tha se deputetët e “komuniteteve tjera” e përkrahin rekomandimin e Komisionit për Buxhet të Kuvendit dhe kërkoi që ekspertët e këtij komuniteti të përfshihen në hartimin e projektligjeve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan dhe shprehën qëndrimet e tyre edhe deputetët: Ramadan Kelmendi, Fatmir Rexhepi, Arsim Bajrami, Ibush Jonuzi, Hydajet

Hyseni,Xhevdet Neziraj,Blerim Baruti,Besa Gaxheri,Flora Brovina,Sabit RrustemiBehxhet Brajshori,Edi Shukriu dhe Ali Sadriu,diskutimet e të cilëve i janë bashkangjitur transkriptit.

Kuvendi pasi diskutoi,miratoi rekomandimet e Komisionit për Buxhet me 74 vota për,asnjë kundër dhe një abstenim.

Seanca përfndoi në orën 14:35minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  
akademik Nexhat Daci**